



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0088

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi - Kryetar, Vedat Poterqoi - Anëtar, Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE Arhiko .ING O.P., Al Group PRO SH.P.K., ENG IDEA SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve detale 3 lloje” me numër të prokurimit 613-22-10640-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Lipjanit, më 12/05/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohen**, si te pabazuara ankesa e Arhiko ING O.P me nr. 2023/0088, e datës 15/02/2023 dhe ankesa e OE Al Group PRO SH.P.K. me nr. 2023/0092 e dates 16/02/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve detale 3 lloje”, me numër të prokurimit 613-22-10640-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Lipjanit, ndërkaq vendimi i AK-se per Llot 1 dhe 2 te vërtetohet.
2. **Aprovohet** si e bazuar ankesa e OE Eng Idea SH.P.K me nr. 2023/0098 e dates 19/02/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve detale” Lloti 3, me numër të prokurimit 613-22-10640-2-1-1 dhe aktiviteti i prokurimit te AK-se KK Lipjan per Llot 3 te rivlerësohet.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues Arhiko ING O.P dhe OE Al Group PRO SH.P.K. i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
4. Operatorit ekonomik Eng Idea SH.P.K, i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 07.10.2022, Komuna e Lipjanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve detale 3 llote” me nr. të prokurimit: 613-22-10640-2-1-1.

Me datën 28.10.2022, AK ka publikuar formularin për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara.

OE Arhiko ING O.P., Al Group PRO SH.P.K., ENG IDEA SH.P.K. me datën 07. 02. 2023 dhe 08. 02. 2023 kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 09. 02. 2023 AK – Komuna e Lipjanit me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

Kundër vendimit të AK-së në OSHP, përmes sistemit të e-prokurimit, me datën 15.02.2023, OE “Arhiko .ING O.P.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0088, kundër njoftimi0074 mbi Vendimin e AK-së për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Hartimi i projekteve detale 3 llote” me nr. të prokurimit: "613-22-10640-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Lipjanit.

Me datën: 16.02.2023, OE “Al Group PRO SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0092, ndërsa me datën 19.02.2023, OE “ENG IDEA SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0098 për aktivitetin e sipërcituar

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 06 mars 2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Arhiko ING O.P

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Al Group PRO SH.P.K

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Eng Idea SH.P.K

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim

Përgjigje te pretendimet e OE Arhiko ING O.P.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

Ky vendim i marre me datën 02.02.2023 është një vendim i përsëritur, pasi që ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim, kërkesa jonë është marre e bazuar dhe kundër këtij vendim në lidhje me kërkesën tonë prape është marrë i njëjti vendim i autoritetit duke shpallur po të njëjtit OE fitues. Ne e kemi të paqartë këtë vendim të ripërsëritur edhe pas qasjes së mundësuar, ku kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues dokumentet shtesë që kanë kërkuar nga Operatorët Ekonomik, por Autoriteti nuk ka kërkuar asnjë informatë shtesë nga ata por vetëm e ka rishpallur vendimin. Pas qasjeve që kishim ne kemi hasur në pa rregullsitë si në vijim pasi që këto parregullsi janë në shkelje me Rregullat, Udhëzuesit dhe Ligjet në fuqi. Me datën 12.01.2023 na është kërkuar letër sqarim për diplomat e prezantuar nga ana jone ku ne edhe i kemi dorëzuar, ne e kemi te paqarte se pse na është kërkuar ky sqarim neve dhe jo edhe kompanive tjera si: Enggroup shpk, Master Architects shpk, Geo-Map nsh, News shpk, Infra-Plus shpk& Alb architect shpk, Studio Hapësira shpk&Taulant shpk, ku nuk ka fare përputhje te diplomave te prezantuar dhe noterizimeve. Andaj shihet qe këtu kemi te bëjmë me shkeljen e Neni 7 i LPP: Barazia në trajtim jo diskriminimi pasi qe e njëjta gjë do te duhej ti kërkohej edhe këtyre operatoreve ekonomik pasi qe nuk ka fare përputhje dhe shumica nga to as që shihen dhe autoriteti ka bërë shkelje.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se AK i ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik ankues ne lidhje me noterizimin e diplomave me datë 12.01.2023 dhe OE i është përgjigjur AK-së sipas kërkesës së tyre, ndërsa lidhur me arsyen se pse AK nuk ju ka kërkuar kompanive tjera sqarime, eksperti shqyrtues vlerëson se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është detyrë e Autoritetit kontraktues dhe komisioni i AK-së e ka për obligim që të bëjë vlerësimin e ofertave konform kërkesave dhe konform dispozitave ligjore të LPP-së.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues pretendon se GOE Enggroup shpk, Al Engineriing shpk Sigurimi i tenderit i 2 Lloteve është ne një vend, nuk është i ndare sipas kërkesës ne dosjen e tenderit

Andaj kjo e bene këtë OE te papërgjegjshëm pasi qe sigurimi nuk është sipas kërkesës se dosjes se tenderit. Dhe bazuar ne Udhëzues Nr. 001/2023 për prokurimin publik -Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik- 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve andaj si i tille duke u mbështetur ne rregullore ky është dashur te eliminohet.

Në dokumentacionin e ofruar në E prokurim, OE i rekomanduar për kontratë Lot 1 “ENGGROUP Sh.p.k”, i cili Sigurimin e tenderit e ka ofruar të ndarë në të tre Lote, andaj pretendimi i OE ankues është i pa qëndrueshëm. Shih në vijim Sigurinë e tenderit për lot 1

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

OE ankues thotë se GOE Geo-Map nsh, News shpk Ne kontrata e punës se inxhinierëve të angazhuar janë kontrate të cilat nuk janë të pa bazuara në ligjet në fuqi dhe sipas kërkesës së parashtruar tek ne për diplomat e noterizuar njeherit është dashur të kërkohej edhe nga OE në fjalë pasi shihet që ka mos përputhje mes diplomave dhe noterizimeve.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, ekspertit shqyrtues sqaron se GOE “Map nsh, News shpk” në listën e tij ka ofruar inxhinierët të angazhuar në këtë projekt ku ka bashkëngjitur edhe dëshmitë sipas kërkesës. AK e ka eliminuar GOE “Map nsh, News shpk” nga ky aktivitet i prokurimit dhe se i njëjti nuk ka paraqitur ankesë në OSHP.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

OE ankues thekson se: GOE Proing&partners shpk, Dea Group shpk, A2 engineering shpk. Në kontrata e punës së inxhinierëve të angazhuar janë kontrate të cilat nuk janë të pa bazuara në ligjet në fuqi dhe sipas kërkesës së parashtruar tek ne për diplomat e noterizuar njeherit edhe dashur të kërkohej edhe nga OE në fjalë pasi shihet që ka mos përputhje mes diplomave dhe noterizimeve

Për këtë pretendim ankimor ekspertit shqyrtues sqaron se GOE “Proing&partners shpk, Dea Group shpk, A2 engineering shpk”, ka paraqitur në ofertën e tij dëshmitë në lidhje me inxhinierët e angazhuar për këtë aktivitet të prokurimit, dhe se i njëjti nuk është rekomanduar për ndonjërin nga Lotet në këtë aktivitet të prokurimit, gjithashtu GOE nuk ka paraqitur ankesë në OSHP që në fakt është pajtuar me eliminimin e tij.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 5

GOE “Infra-Plus shpk& Alb architect shpk” - Në përshkrimin e çmimit Paramasa në Lot 2-mungon çmimi në një pozicion andaj kjo e bënë këtë OE të papërgjegjshëm në këtë llot - Sigurimi i tenderit i 2 Llojeve është në një vend, nuk është i ndare sipas kërkesës në dosjen e tenderit

Lidhur me këtë pretendim ankimor, Ekspertit Shqyrtues sqaron se GOE “Infra-Plus shpk& Alb architect shpk”, është rekomanduar për kontratë për Lot 3, dhe pretendimi i OE ankues se një pozicion i paramasës në Lot 2 mungon çmimi nuk e bënë të pa përgjegjshëm GOE “Infra-Plus shpk& Alb architect shpk”, për faktin se i njëjti është rekomanduar për kontratë për Lot 3 dhe jo për Lot 2, andaj pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 6

GOE “Enggroup SHPK & MasterArchitecture” në fjalë është shpallur fitues i lot 1 ku pas qasjes në dokumente zyrtare dhe në dokumentet për informata shtese shihet kërkesa e autoritetit kontraktues:

Dokumenti nga ATK dhe gjykata janë kërkuar të jenë të lëshuara se paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të njoftimit të kontratës, njoftimi për kontratë është i shpallur me datën 07.10.2022. që i bie dokumentet duhet të jenë para kësaj date ndërsa GOE në fjalë për: Vërtetimin e gjykatës Enggroup ka ofruar të datës 16.01.2023 Vërtetimin e gjykatës Master Architecture ka ofruar të datës 17.01.2023 Vërtetimin e ATK-së Enggroup ka ofruar të datës 14.12.2022 Vërtetimin e ATK-s MasterArchitecture ka ofruar të datës 17.01.2023. Ku shihet qartas që GOE në fjalë nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuar në kërkesën për informata shtese

andaj si i tille ky GOE duhet te jete eliminuar pasi qe nuk ka përmbushur kërkesat e AK.

Eksperti Shqyrtues, sqaron se dokumentet e kërkuara nga AK si vërtetimi i ATK-së dhe dëshmia e gjykatës, edhe pse dokumentet mbajnë datën 14.10.2022 dhe 02.11.2022, dokumentet janë te pranueshme për faktin se AK ka kërkuar vetëm për tenderuesit fitues dhe kjo ka kuptimin që 3 muaj para njoftimit për kontratë OE të mos ketë obligime ndaj ATK-së dhe t'i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 7

GOE Studio Hapësira & Taulanti SHPK ne fjale është shpallur fitues i lot 2 ku pas qasjes ne dokumente zyrtare dhe ne dokumentet për informata shtese shihet kërkesa e autoritetit kontraktues:

Dokumenti nga ATK dhe gjykata janë kërkuar te jene te lëshuara se paku deri ne tremujorin e fundit para datës se publikimit te njoftimit te kontratës, njoftimi për kontrate është i shpallur me datën 07.10.2022. qe i bie dokumentet duhet te jene para kësaj date ndërsa GOE ne fjale për: Vërtetimin e gjykatës Studio Hapësira ka ofruar te datës 12.01.2023 Vërtetimin e gjykatës Taulanti Shpk ka ofruar te datës 17.11.2022 Vërtetimin e ATK-s Studio Hapësira ka ofruar te datës 16.11.2022 6/3 Vërtetimin e ATK-s Taulanti Shpk ka ofruar te datës 16.11.2022 Ku shihet qartas qe GOE ne fjale nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuar ne kërkesën për informata shtese andaj si i tille ky GOE duhet te jete eliminuar pasi qe nuk ka përmbushur kërkesat e AK Gjate shqimit dhe analizimit te ofertave është vërejtur qe fituesit janë shpallur fitues ne baze te çmimit me te ulet ne llot ku ne baze te rregullores duhet te shpallet ne llotin te cilin është me çmimin me te larte, dhe jo çmimin me te ulet siç është vepruar. Kjo është shkelje e Rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik-Neni 18-Ndarja e kontratave ne Lote.

Eksperti Shqyrtues, sqaron se dokumentet e kërkuara nga AK si vërtetimi i ATK-së dhe dëshmia e gjykatës, edhe pse dokumentet mbajnë datën pas njoftimit për kontratë, dokumentet janë te pranueshme për faktin se AK ka kërkuar vetëm për tenderuesit fitues dhe kjo ka kuptimin që 3 muaj para njoftimit për kontratë OE të mos ketë obligime ndaj ATK-së dhe t'i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë.

Ndërsa në lidhje me çmimet, eksperti shqyrtues sqaron se në nenin 30.1 të dosjes së tenderit është përcaktuar kriteri i dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët i poentuar. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Përgjigje te pretendimet e OE Al Group PRO SH.P.K.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

Pas qasjes në dokumentacion zyrtarë kemi hasur në disa parregullsi një kërkesë e iniciuar nga vet ana e AK-së dhe duke shkelur mbi këtë kërkesë, kërkesa për dokumentacion shtesë të përshtatshmërisë sipas AK-së ishte: “Kërkesat e përshtatshmërisë të jenë të lëshuara së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës”. në këtë kërkesë përfshihen vërtetimi i ATK-së dhe Vërtetimi i Gjykatës me po një kërkesë te tille AK rekomandon për shpërblim me kontrate për llot 2 Grupin e OE Studio Hapësira SH.P.K; Taulanti SH.P.K qe dokumentacionin ne fjale e kanë prezantuar pas datës së njoftimit me kontratë. Andaj një prezantim i tillë i dokumentacionit duke mos përmbushur kriteret e përcaktuara sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi do të duhej të dërgoj në eliminim këtë grup të OE e jo të rekomandohet

për shpërblim me kontratë siç keni vepruar në këtë rast ju si AK duke rënë ndesh me kërkesat e juaja. Andaj shihet që këtu kemi të bëjmë me shkeljen e Nenit 7 i LPP: Barazia në trajtim jo diskriminimi pasi që e njëjta gjë do të duhej ti kërkohej edhe këtyre operatoreve ekonomik pasi që nuk ka fare përputhje.

Eksperti Shqyrtues, konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *“a).Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 .Neni 65. b)Në dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. c)Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmërisë të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës”.*

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar:*“a).Në deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit. b).Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje). c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për çështje Ekonomike i lëshuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit (kopje). Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës”.*

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë Lot2 ka sjellur dokumentet e kërkuara të të cilët mbajnë datën 16.11.2022 dëshmia e ATK-së, dhe vërtetimi i gjykatës komerciale me dt. 17.11.2022. Eksperti Shqyrtues vlerëson se dokumentet e lartcekura të kërkuara nga AK-ja, janë dëshmi që AK i kërkon në momentin e propozimit për kontratë të një operatori ekonomik. Pretendimi i OE ankues se dokumentet janë pas datës së njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues për faktin se periudha 3 muaj para njoftimit për kontratë nënkupton që OE edhe pse data e dëshmimeve të kërkuara nga AK-ja është pas datës së njoftimit për kontratë, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë Lot 2 plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për shkak se kërkesa e dosjes nënkupton që OE në tre muajt e fundit para datës së njoftimit për kontratë nuk janë në vonesë të tatimeve.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

Edhe tek Grupi i OE i rekomanduar për shpërblim me kontratë për llot 1 Enggroup SHPK & Master Architecture kemi hasur të njëjtin lëshim të bere nga ana juaj si AK me shpalljen e fituesit me po të njëjtin gabim si për Grupin e OE të lartcekur. Dokumentacioni i kërkuar ishte vërtetimi nga ATK dhe vërtetimi nga gjykata janë kërkuara të jene të lësuara se paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të njoftimit të kontratës, njoftimi për kontratë është i shpallur me datën 07.10.2022. që i bie dokumentet duhet të jene para kësaj date. Andaj një prezantim i tillë i dokumentacionit duke mos përmbushur kriteret e përcaktuara sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi do të duhej të dërgoj në eliminimi këtë grup të OE e jo të rekomandohet për shpërblim me kontratë siç keni vepruar në këtë rast ju si AK duke rënë ndesh me kërkesat e juaja.

Eksperti Shqyrtues, konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *“a).Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin*

Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 Neni 65. b)Në dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. c) Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmërisë të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës”.

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “a).Në deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit. b).Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje). c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për çështje Ekonomike i lëshuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit (kopje). Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës”.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë Lot 1 ka sjellë dokumentet e kërkuara te të cilët mbajnë datën 14.12.2022 dëshmia e ATK-së, dhe vërtetimi i gjykatës komerciale me dt. 17.01.2023. Eksperti Shqyrtues vlerëson se dokumentet e lartcekura të kërkuara nga AK-ja, janë dëshmi që AK i kërkon në momentin e propozimit për kontratë të një operatori ekonomik. Pretendimi i OE ankues se dokumentet janë pas datës së njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues për faktin se periudha 3 muaj para njoftimit për kontratë nënkupton që OE edhe pse data e dëshmive të kërkuara nga AK-ja është pas datës së njoftimit për kontratë, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë Lot 1 plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për shkak se kërkesa e dosjes nënkupton që OE në tre muajt e fundit para datës së njoftimit për kontratë nuk janë në vonesë të tatimeve.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

Ne grupin e OE Infra-Plus SH.P.K; ALB Architect SH.P.K të rekomanduar për shpërblim me kontratë Lot 3, pas verifikimit të dokumentacionit në përshkrimin e çmimit Paramasa në Lot 2 në pozicionin 6 - mungon çmimi në këtë pozicion, duke iu referuar nenit 41.15 të Roupp në rast që OE nuk ka çmim në një pozicion atëherë tenderi refuzohet. - Grupi i OE ka ofruar sigurimin e tenderit në një shumë të përbashkët për tre(3) llotet andaj me këtë pikë grupi i OE ka bere shkelje te nenit 57 paragrafi 4 ku sipas këtij neni AK ka vendosur kushte për sigurimin e tenderit duke kërkuar sigurimin e ndare për secilin nga llotet. Andaj kjo e bënë këtë OE të papërgjegjshëm pasi që sigurimi nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit të përcaktuar nga ana e AK-së Sipas nenit të lartcekur Sigurimi nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde Refuzo tenderin pa kërkuar sqarim shtese. Edhe në grupin e OE te lartcekur kemi hasur te njëjtin lëshim te bere nga ana juaj si AK me shpalljen e fituesit me po te njëjtin gabim si për Grupin e OE te lartcekur. Dokumentacioni i kërkuar ishte vërtetimi nga ATK dhe vërtetimi nga gjykata janë kërkuar te jene te lëshuara se paku deri ne tremujorin e fundit para datës së publikimit të njoftimit të kontratës, njoftimi për kontratë është i shpallur me datën: 07.10.2022. që i bie dokumentet duhet të jenë para kësaj date. Ku shihet qartas që GOE në fjalë nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuar në kërkesën për informata shtesë andaj si i tillë ky GOE duhet te jete eliminuar pasi qe nuk ka përmbushur kërkesat e AK.

Eksperti Shqyrtues pasi ka analizuar dokumentet e ofruar në E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit, sqaron se OE “Infra-Plus SH.P.K; ALB Architect SH.P.K” është rekomanduar për kontratë për Lot 3, dhe në paramasën për Lot 3 nuk ka ndonjë rubrikë në të cilën OE ankues nuk ka vendosur çmim, ndërsa për paramasën e Llot 2 OE “Infra-Plus SH.P.K; ALB Architect SH.P.K” nuk është i rekomanduar për kontratë për këtë Lot, andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar.

Lidhur me Sigurimin te tenderit, në dosje të tenderit në nenin 13.2 AK ka kërkuar që shuma e Tenderit të jetë Lot1=2000 Euro, Lot 2=4000 Euro, Lot 3= 3000 Euro. Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë për Llot 3 ka dorëzuar sigurimin e tenderit për të tre Lotet në vlerë 9000 Euro, eksperti shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë Llot 3 ka dorëzuar Sigurimin e tenderit dhe pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

Në vendimin e pranuar për shpërblimin me kontratë ju si AK keni bërë shkelje procedurale të shpërblimit me kontratë në një tender të ndarë me lloje, ku sipas nenit 18.5 të Roupp kur një tender është i ndarë në lloje dhe AK vendos të kufizojë numrin e lotëve që do të shpërblehet një OE, AK do të duhet të vijoj që përmbushja e kërkesave minimale të jetë shuma më e lartë për llojet të cilat konkurron OE. Me këtë procedurë dhe vendim ju si AK keni bërë shkelje të nenit të lartcekur sa i përket procedurës në shpërblimin e kontratës me lloje dhe një kërkesë të bërë nga ana juaj si AK të cekur në dosjen e tenderit. Për arsyet e lartcekura konsiderojmë se vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim të datës: 07.02.2023 si dhe njoftimi për dhënie të kontratës i datës: 03.02.2023 janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga AK si dhe në kundërshtim me dispozitat e lartcekura të LPP-së.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se në këtë aktivitet të prokurimit të ndarë në tre lloje AK- ka rekomanduar për kontratë nga një GOE për secilin Llot, dhe është e drejtë e AK-së të përcaktoj ndarjen në lloje të një aktiviteti të prokurimit apo jo, andaj eksperti shqyrtues konsideron që AK nuk ka bërë shkelje procedurale në rastin e ndarjes në lloje dhe shpërblimit për kontratë operatorët ekonomik me nga një lot. Andaj pretendimi i OE ankues është i pa qëndrueshëm.

Përgjigje te pretendimet e OE Eng Idea SH.P.K.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues thekson se me datën 01.02.2023 AK Komuna e Lipjanit ka dërguar letër standarde për sqarimin e tenderit ku ka kërkuar.

Menjëherë me datën 02.02.2023 ne kemi dërguar përgjigje në Letrën Standarde për sqarim të tenderit, ku edhe kemi argumentuar se pse nuk pajtohem me arsyen e eliminimit të kompanisë sonë nga ana e AK-së.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar dokumentacionin e ofruar në E prokurim sqaron se OE ankues në Letrën standarde si arsye të eliminimit janë: Referenca e paraqitur për projektin Shërbimet e projektimit dhe dizajnit të projekteve për nevojat e FSKK dhe MM nuk mund të pranohet për arsye se siç e keni cek dhe ju në listë të projekteve është nga kontrata e cila nuk ka përfunduar d.m.th është ende aktive. Si dhe arsye tjetër është Referenca për kontratat e lëshuar nga Ministria e Mbrotjtjes për kontratën Shërbime të projektimit dhe dizajnimet të

projekteve infrastrukturës për nevojat e “FSK” dhe MFSK-së nuk mund të pranohet se referenca është e datës 11.02.2013 ndërsa njoftimi për kontratë është e datës 07.10.2022 që d.m.th i ka më shumë se 3 vite para publikimit të njoftimit për kontratë.

OE ankues në Ofertë ka bashkangjitur një listë të projekteve të kompanisë e cila është e datës 25.03.2022, për të cilën thotë se është përvjedhur gabimisht një dokument i pa përditësuar. Eksperti shqyrtues, thekson se OE është dashur të jetë i vëmendshëm me dokumentet me të cilat oferton dhe nuk mund të fajësoj AK-në se pse nuk e ka shfrytëzuar Nenin 72 të LPP-së për të kërkuar sqarime, pasi që AK bënë publikimin e njoftimit për kontratë dhe nëse OE dëshiron të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit, nevojitet ti përmbush kërkesat e autoritetit kontraktues.

Gjithashtu, OE ankues ka bashkangjitur me ankesë kontratën me titull: “Shërbimet të projektimit dhe dizajnit të projekteve të infrastrukturës për nevojat e FSK dhe MM”, sipas përshkrimit të dhënë në kontratë, kjo kontratë është lidhur me datë 17.05.2021 dhe është kontratë kornizë 24 muaj. Gjithashtu për këtë kontratë është lëshuar një referencë për punët të cilët janë projektuar nga kompania “ENG IDEA sh.p.k”, në të cilën është theksuar vlera 83 918.56 Euro. Gjithashtu është bashkangjitur edhe raporti i menaxherit të projektit i datës 30.10.202, ku në paragrafin e parafundit të raportit thuhet si në vijim:

Andaj, nga pasqyra e dhënë si më lartë, eksperti shqyrtues sqaron se meqë është kontratë kornizë dhe mund të jetë përmbushur para kohe dhe në bazë të të dhënave të paraqitura rezultojnë që kontrata në fjalë është përmbushur, mirëpo eksperti shqyrtues rekomandon që AK- të kërkojë sqarime nga Ministria e Mbrojtjes dhe të konstatojë nëse kjo kontratë është e realizuar sipas dëshmive të paraqitura.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues thekson se Komisioni vlerësues i AK komuna e Lipjanit nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE ofertues duke shkelur Nenin 1,6,7 dhe nenet 65-71 të LPP-së për dhënie të kontratës e sidomos nenin 60 të LPP-së, pasi që duke eliminuar në mënyrë të pa drejt OE “ENG IDEA sh.p.k” dëmton buxhetin e republikës së Kosovës.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se në Nenin 30.1 të dosjes së tenderit, kriter i dhënies së kontratës është Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët i poentuar, andaj kjo ka kuptimin që operatorët ekonomik së pari të jenë të përgjegjshëm në kuptimin administrativ dhe më pas të shikohet çmimi.

Eksperti shqyrtues rekomandon që gjatë rivlerësimit të Aktivitetit të Prokurimit për Lotin 3, AK të bëjë verifikimin e kontratës me titull: “Shërbimet të projektimit dhe dizajnit të projekteve të infrastrukturës për nevojat e FSK dhe MM”, dhe të konstatojë përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik, në mënyrë që të rekomandohet operatori i përgjegjshëm me çmimin më të lirë të poentuar.

Me mendimin e ekspertit shqyrtues për Llot 1 dhe 2 u pajtua AK, ndërsa nuk u pajtua OE Arhiko ING O.P dhe OE Al Group PRO SH.P.K, ndërsa për Llot 3 me mendimin e ekspertit shqyrtues u pajtua pjesërisht OE ENG IDEA shpk ndërsa nuk është pajtuar autoriteti kontraktues.

Paneli Shqyrtues analizoi shkresat e kësaj lënde, pohimet ankimore, veprimet e ndërmarra nga palët dhe shqyrtimin paraprak të ekspertit dhe duke i krahasuar të gjitha ato, konsideron se

Raporti i cituar si më sipër i Ekspertit Shqyrtues përmban analiza dhe vlerësime profesionale lidhur me çështjen në rastin konkret dhe se rekomandimet e tija si më sipër tuj janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli ne pretendimet si në vijim sepse:

Lidhur me pretendimet e OE ankues të parë Arhiko ING O.P për shkelje të nenit 7 të LPP-së me pretendimin se nuk jan trajtuar drejtë nga OE ankues paneli shqyrtues sqaron se AK i ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik ankues ne lidhje me noterizimin e diplomave me datë 12.01.2023 dhe OE i është përgjigjur AK-së sipas kërkesës së tyre, ndërsa lidhur me arsyen se pse AK nuk ju ka kërkuar kompanive tjera sqarime, paneli shqyrtues vlerëson se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është detyrë e Autoritetit kontraktues dhe komisioni i AK-së e ka për obligim që të bëjë vlerësimin e ofertave konform kërkesave dhe dispozitave ligjore të LPP-së.

Sa i përket pretendimit për sigurimin e tenderëve për Oe të rekomanduar, paneli shqyrtues sqaron se ë dokumentacionin e ofruar në E prokurim, OE i rekomanduar për kontratë Lot 1 “ENGGROUP Sh.p.k”, i cili Sigurimin e tenderit e ka ofruar të ndarë në të tre Lote, andaj pretendimi i OE ankues është i pa qëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se GOE Geo-Map nsh, News shpk ne kontrata e punës se inxhinierëve te angazhuar janë kontrate te cilat nuk janë te pa bazuara ne ligjet ne fuqi dhe sipas kërkesës se parashtruar tek ne për diplomat e noterizuara njeherit është dashur te kërkohen edhe nga OE ne fjale pasi shihet qe ka mos përputhje mes diplomave dhe noterizimeve, paneli shqyrtues sqaron se GOE “Map nsh, News shpk” ne listën e tije ka ofruar inxhinieret te angazhuar ne këtë projekt ku ka bashkëngjit edhe dëshmitë sipas kërkesës. AK e ka eliminuar GOE “Map nsh, News shpk” nga ky aktivitet i prokurimit dhe se i njëjti nuk ka paraqit ankese ne OSHP.

Në lidhje me pretendimin ankimor se GOE Proing&partners shpk, Dea Group shpk, A2 engineering shpk ka mos përputhje mes diplomave dhe noterizimeve, paneli shqyrtues sqaron se GOE “Proing&partners shpk, Dea Group shpk, A2 engineering shpk”, ka paraqitur në ofertën e tij dëshmitë në lidhje me inxhinierët e angazhuar për këtë aktivitet të prokurimit, dhe se i njëjti nuk është rekomanduar për ndonjërin nga Lotet në këtë aktivitet të prokurimit, gjithashtu GOE nuk ka paraqit ankesë në OSHP që në fakt është pajtuar me eliminimin e tij.

Në lidhje me pretendimin ankimor për GOE “Infra-Plus shpk& Alb architect shpk” se në përshkrimin e çmimit Paramasa ne Lot 2- mungon çmimi ne një pozicion paneli sqaron se GOE “Infra-Plus shpk& Alb architect shpk”, është rekomanduar për kontratë për Lot 3, dhe pretendimi i OE ankues se një pozicion i paramasës në Lot 2 mungon çmimi nuk e bënë të pa përgjegjshëm GOE “Infra-Plus shpk& Alb architect shpk”, për faktin se i njëjti është rekomanduar për kontratë për Lot 3 dhe jo për Lot 2.

Sa i përket pretendimit për GOE “Enggroup SHPK & MasterArchitecture” për mungesën e dokumenteve sipas nenit 65 të LPP-së, paneli shqyrtues sqaron se dokumentet e kërkuara nga AK si vërtetimi i ATK-së dhe dëshmia e gjykatës, edhe pse dokumentet mbajnë datën 14.10.2022 dhe 02.11.2022, dokumentet janë te pranueshme për faktin se AK ka kërkuar vetëm për tenderuesit fitues dhe kjo ka kuptimin që 3 muaj para njoftimit për kontratë OE të mos ketë obligime ndaj ATK-së dhe t’i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë.

Lidhur me pretendimin për GOE Studio Hapësira & Taulanti SHPK i shpallur fitues i lot 2 për mungesën e dokumentit nga ATK dhe gjykata ashtu siç është e paraparë në dosje të tenderit (kërkesës së dosjes) paneli sqaron se dokumentet e kërkuara nga AK si vërtetimi i ATK-së dhe

dëshmia e gjykatës, edhe pse dokumentet mbajnë datën pas njoftimit për kontratë, dokumentet janë te pranueshme për faktin se AK ka kërkuar vetëm për tenderuesit fitues dhe kjo ka kuptimin që 3 muaj para njoftimit për kontratë OE të mos ketë obligime ndaj ATK-së dhe t'i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE Al Group PRO SH.P.K për mos plotësim të kërkesat e dosjes së tenderit, sqarimeve shtesë paneli shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *“a).Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 .Neni 65. b)Në dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. c)Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmërisë të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës”.*

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: *“a).Në deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit. b).Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje). c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për çështje Ekonomike i lëshuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit (kopje). Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës”.*

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë Lot2 ka sjellur dokumentet e kërkuara të cilët mbajnë datën 16.11.2022 dëshmia e ATK-së, dhe vërtetimi i gjykatës komerciale me dt. 17.11.2022. Duke u bazuar në këtë, paneli shqyrtues vlerëson se dokumentet e lartcekura të kërkuara nga AK-ja, janë dëshmi që AK i kërkon në momentin e propozimit për kontratë të një operatori ekonomik. Pretendimi i OE ankues se dokumentet janë pas datës së njoftimit për kontratë, janë të paqëndrueshme për faktin se periudha 3 muaj para njoftimit për kontratë nënkupton që OE edhe pse data e dëshmimeve të kërkuara nga AK-ja është pas datës së njoftimit për kontratë. Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë Lot 2 plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për shkak se kërkesa e dosjes nënkupton qe OE në tre muajt e fundit para datës së njoftimit për kontratë nuk janë në vonesë të tatimeve.

Të njëjtin pretendim OE ankues e ka për OE të rekomanduar për Llot1 Enggroup SHPK & Master. Paneli shqyrtues duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit të sqaruar si më lartë sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë Lot 1 ka sjellë dokumentet e kërkuara të cilët mbajnë datën 14.12.2022 dëshmia e ATK-së, dhe vërtetimi i gjykatës komerciale me dt. 17.01.2023. Dokumentet e lartcekura të kërkuara nga AK-ja, janë dëshmi që AK i kërkon në momentin e propozimit për kontratë të një operatori ekonomik. Pretendimi i OE ankues se dokumentet janë pas datës së njoftimit për kontratë, nuk janë të qëndrueshme për faktin se periudha 3 muaj para njoftimit për kontratë nënkupton që OE edhe pse data e dëshmimeve të kërkuara nga AK-ja është pas datës së njoftimit për kontratë. Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë Lot 1 plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për shkak se kërkesa e dosjes nënkupton qe OE në tre muajt e fundit para datës së njoftimit për kontratë nuk janë në vonesë të tatimeve.

Lidhur me pretendimet për grupin e OE Infra-Plus SH.P.K; ALB Architect SH.P.K të rekomanduar për shpërblim me kontratë Lot 3, se në përshkrimin e çmimit Paramasa në Lot 2 ne

pozicionin 6 - mungon çmimi në këtë pozicion, paneli shqyrtues sqaron se në e-prokurim për këtë aktivitet të prokurimit, OE “Infra-Plus SH.P.K; ALB Architect SH.P.K” është rekomanduar për kontratë për Lot 3, dhe në paramasën për Lot 3 nuk ka ndonjë rubrikë në të cilën OE ankues nuk ka vendosur çmim, ndërsa për paramasën e Llot 2 OE “Infra-Plus SH.P.K; ALB Architect SH.P.K” nuk është i rekomanduar për kontratë për këtë Lot. Lidhur me Sigurimin të tenderit, në dosje të tenderit në nenin 13.2 AK ka kërkuar që shuma e Tenderit të jetë Lot1=2000 Euro, Lot 2=4000 Euro, Lot 3= 3000 Euro. Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë për Llot 3 ka dorëzuar sigurimin e tenderit për të tre Lotet në vlerë 9000 Euro, paneli shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë Llot 3 ka dorëzuar Sigurimin e tenderit dhe pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor se AK vendos të kufizojë numrin e lotëve që do të shpërblehet një OE, paneli shqyrtues sqaron se në këtë aktivitet të prokurimit të ndarë në tre lote AK- ka rekomanduar për kontratë nga një GOE për secilin Llot, dhe është e drejtë e AK-së të përcaktoj ndarjen në lote të një aktiviteti të prokurimit apo jo, andaj eksperti shqyrtues konsideron që AK nuk ka bërë shkelje procedurale në rastin e ndarjes në lote dhe shpërblimit për kontratë operatorët ekonomik me nga një lot.

Paneli shqyrtues shqyrtoj dhe analizoj pretendimet ankimore të OE të tretë ankues Eng Idea Sh.P.K. Lidhur me pretendimin ankimor për letrën standarde të eliminimit paneli shqyrtues sqaron se në dokumentacionin e ofruar në e-prokurim për OE ankues në letrën standarde si arsye të eliminimit janë: Referenca e paraqitur për projektin Shërbimet e projektimit dhe dizajnit të projekteve për nevojat e FSKK dhe MM nuk mund të pranohet për arsye se siç e keni cek dhe ju në listë e projekteve është nga kontrata e cila nuk ka përfunduar d.m.th është ende aktive. Si dhe arsye tjetër është Referenca për kontratat e lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes për kontratën Shërbime të projektimit dhe dizajnit të projekteve infrastrukturës për nevojat e “FSK” dhe MFSK-së nuk mund të pranohet se referenca është e datës 11.02.2013 ndërsa njoftimi për kontratë është e datës 07.10.2022 që d.m.th i ka më shumë se 3 vite para publikimit të njoftimit për kontratë. OE ankues në Ofertë ka bashkangjitur një listë të projekteve të kompanisë e cila është e datës 25.03.2022, për të cilën thotë se është përvjedhur gabimisht një dokument i pa përditësuar. Paneli shqyrtues, thekson se OE është dashur të jetë i vëmendshëm me dokumentet me të cilat oferton por AK është e obliguar që konform neni 72 të LPP-së të kërkoj sqarime, pasi që AK bënë publikimin e njoftimit për kontratë dhe nëse OE dëshiron të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit, nevojitet ti përmbush kërkesat e autoritetit kontraktues, por në të gjitha rastet kur ka informatat jo të qarta në ofertat e ofertueseve, AK duhet të kërkoj sqarime shtesë për të bërë ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave.

Gjithashtu, OE ankues ka bashkangjitur me ankesë kontratën me titull: “Shërbimet të projektimit dhe dizajnit të projekteve të infrastrukturës për nevojat e FSK dhe MM”, sipas përshkrimit të dhënë në kontratë, kjo kontratë është lidhur me datë 17.05.2021 dhe është kontratë kornizë 24 muaj. Gjithashtu për këtë kontratë është lëshuar një referencë për punët të cilët janë projektuar nga kompania “ENG IDEA sh.p.k”, në të cilën është theksuar vlera 83 918.56 Euro. Poashtu, është bashkangjitur edhe raporti i menaxherit të projektit i datës 30.10.202, ku në paragrafin e parafundit të raportit thuhet se kontrata konsiderohet e përfunduar.

Andaj, nga thënat si më lartë, paneli shqyrtues sqaron se meqë është kontratë kornizë dhe mund të jetë përmbushur para kohe dhe në bazë të të dhënave të paraqitura rezulton që kontrata në fjalë është përmbushur, mirëpo paneli shqyrtues vlerëson që AK- të kërkojë sqarime nga Ministria e Mbrojtjes dhe të konstatojë nëse kjo kontratë është e realizuar sipas dëshmive të

paraqitura.

Në ankesë OE ankues thekson se Komisioni vlerësues i AK komuna e Lipjanit nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE ofertues duke shkelur Nenin 1,6,7 dhe nenet 65-71 të LPP-së për dhënie të kontratës e sidomos nenin 60 të LPP-së, pasi që duke eliminuar në mënyrë të pa drejt OE “ENG IDEA sh.p.k” dëmton buxhetin e republikës së Kosovës.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, paneli shqyrtues sqaron se në Nenin 30.1 të dosjes së tenderit, kriter i dhënies së kontratës është Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët i poentuar, andaj kjo ka kuptimin që operatorët ekonomik së pari të jenë të përgjegjshëm në kuptimin administrativ dhe më pas të shikohet çmimi.

Paneli shqyrtues rekomandon që gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit për Lotin 3, AK duke u bazuar në nenin 72 dhe nenin 59. 2 të LPP-së të bëjë verifikimin e kontratës me titull: “Shërbimet të projektimit dhe dizajnit të projekteve të infrastrukturës për nevojat e FSK dhe MM”, dhe të konstatoj përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik, në mënyrë që të rekomandohet operatori i përgjegjshëm me çmimin më të lirë të poentuar.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vlerëson se Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, ka vepruar në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP për Llot 1 dhe 2, ndërsa për Llot 3 AK duhet të kërkojë sqarime shtesë lidhur me kontratën e ofruar nga OE në mënyrë që ekzaminimi i ofertës të bëhet konform nenit 59 të LPP-së.

- Përfundim -

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se raporti i ekspertit shqyrtues përmban një vlerësim profesional dhe të argumentuar të pohimeve të ankuesit dhe gjitha fakteve dhe rrethanave tjera të analizuar si më sipër prandaj rekomandimet e dhëna janë miratuar edhe nga Paneli Shqyrtues i OSHP. Duke u bazuar në kompetencat e OSHP të rregulluara sipas nenit 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër. Prandaj nisur nga të lartcekurat Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur.

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 4 paragrafi 1 pika 1.36, dhe 104 parg 1, 117, të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - Arhiko .ING O.P., Al Group PRO SH.P.K., ENG IDEA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: